

Roli i medias në formimin e identitetit kombëtar shqiptar në vitet 1925-1944

*Gazmend Leçini**

Hyrje

Periudha pas vitit 1925 karakterizohet nga një stabilitet politik që prodhoi një situatë të favorshme dhe për shtypin shqiptar, i cili me të drejtë themi se e shfrytëzoi më së mirë këtë moment. Kjo gjë vihet re nga numrat e shumtë të gazetave, e sidomos të revistave, që lulëzuan në këtë periudhë. Duket sikur shtypi e gjeti “gjuhën e duhur” me pushtetin e kohës, të cilin herë-herë e thumbonte, por edhe e lajkantonte, në varësi të pozicionit ideologjik që i përkiste.

Emëruesi i përbashkët i shtypit të këtyre viteve, 1925-1944, ishte konsolidimi i identitetit tonë kombëtar, pasi dhe institucionet shtetërore po konsolidoheshin. Shtypi i kësaj periudhe duket sikur iu përgjigj një nevoje të brendshme mbarëkombëtare për theksimin e atyre tipareve që i përbashkonin shqiptarët dhe e orientonin integrimin e tyre brenda strukturave shtetërore shqiptare, edhe pse mund të ishin pjesë e një kulture përtej kufijve shtetërorë shqiptarë. Kam parasysh këtu shkëputjen e Komunitetit Mysliman nga Kalifati me qendër në Turqi, po ashtu dhe përpjekjet e Komunitetit Ortodoks për autoqefali nga patriarkana e Stambollit.

Shtypi i kësaj periudhe ka përdorur forma dhe mjete të ndryshme për ngritjen e vetëdijes kombëtare, dhe secili e ka bërë këtë gjë në formën që e shihte të arsyeshme. Ndryshimi i formave nga njëri organ shtypi tek tjetri ka çuar hera-herës dhe në debate të ashpra ndërmjet botuesve, debate të cilat janë pasqyruar dhe në shtyp.

* *PhD. Cand. Gazmend Leçini. Doktorant në Shkenca e Komunikimit dhe Informimit në Universitetin e Tiranës. Adresa elektronike: gazimobile@hotmail.com*

Metodologjia e përdorur

Për të realizuar këtë punim kam marrë në shqyrtim disa prej organeve më kryesore të shtypit të kësaj periudhe, duke u përqendruar më tepër në ato fetare, për vetë specifikën që kishin botimet e tyre në lidhje me objektin e këtij studimi. U jam referuar gjithashtu dhe disa botimeve të drejtuara nga intelektualë të njohur të kohës, që idetë e tyre se si duhej të ishte identiteti dhe kultura jonë kombëtare i pasqyruan në organet e shtypit që drejtonin, siç do t'i shohim në vijim.

Qasje të ndryshme për qëllime të njëjta

Po t'i shohim me vëmendje shkrimet e kësaj periudhe, që kanë si objekt kryesor dashurinë ndaj atdheut, ruajtjen e unitetit kombëtar, kultivimin e atyre tipareve që na dallojnë nga fqinjët, do të gjejmë se herë pas here kemi revokim të atij ligjërimi që ishte tipik tek autorët e Rilindjes Kombëtare. Shpeshherë ata citoreshin dhe në ligjëratë të drejtë, për t'i sjellë sa më afër, dhe për të qenë sa më bindës tek lexuesi shqiptar.

Vargjet e Vaso Pashës se “Feja e shqiptarit është shqiptaria” tingëllojnë edhe sot e kësaj dite si të jenë thënë këtë fillimshekulli, dhe jo në atë të kaluarin. Pa dashur të bëj një analizë të përmbajtjes, mund të them se duket qartë logjika përjashtuese e dy vargjeve të fundit të poemës “O moj Shqypni”. Duket sikur autori kërkon që t'ua zëvendësojë shqiptarëve fenë e tyre që e praktikojnë, aq sa e praktikojnë, me një “fe” të re, e kjo është “shqiptaria”. Kjo logjikë përjashtuese duket se ka frymëzuar dhe shumë intelektualë që kanë botuar në shtypin e periudhës që unë kam marrë në shqyrtim. Ndaj gjejmë shkrime ku theksohet se duhet të heqim dorë nga disa pjesë të kulturave me karakter mbarëkombëtar, për të krijuar një kulturë puritane shqiptare, larg çdo mbetjeje të kulturave “të vjetra”.

Debati më pas vijonte me atë se cila është kulturë tipike e jona, e cilës periudhë, por dhe çfarë do të huazojmë dhe çfarë jo nga kulturat e tjera të Lindjes apo të Perëndimit.

Branko Merxhani që ndër ideatorët kryesorë të “neoshqiptarizmës”, bashkë me Petro Markun, Tajar Zavalanin, Lasgush Poradecin etj., ideja e të cilëve ishte zhvillimi dhe përparimi i vendit duke pasur si model Perëndimin, por duke qenë të matur, duke iu shmangur ideve individualiste që po përhapeshin në Europë në atë kohë, duke e konsideruar këtë prirje të dëmshme për unitetin tonë kombëtar, që ishte akoma në fillosat e tij.

Mendimet e tyre u pasqyruan në gazetën e përjavshme *Illyria*, e më pas tek *Përpykja Shqiptare*, e cila ishte deri diku vazhdimësi e *Illyria-s*, si nga bashkëpunëtorët, po ashtu dhe nga tematikat e trajtuara aty.¹

Merxhani do të shprehej: “Jemi të shtrënguar, me dashje a pa dashje, të ecim për në Oksident. Por kjo ecja jonë nuk mund të ketë kurrë një kuptim imitimi. ... nga Oksidenti kemi për të marrë vetëm metodat e punimit, vetëm qytetërimin, por kurrë kulturën.”²

Kur flitet për qytetërim, sipas Merxhanit, bëhet fjalë për shpikjet teknologjike, dhe jo për kulturën popullore, ndryshe nga qasja frankofone mbi qytetërimin.

Branko Merxhani mbron idenë e “përmbrendësimit të qytetërimit perëndimor prej kulturës shqiptare, metafora që ai përdor është ajo e gjuhës dhe e fjalëve të huaja që bëhen pjesë e saj.”

Kjo linjë mendimi duket se ishte në unison me atë të Vaso Pashës për krijimin e një feje tjetër, që do të ishte “shqiptaria”.

Por një tjetër autor dhe mendimtar, po ashtu rilindas, ndante tjetër mendim ndaj dualizmit fe-atdhe. Ai nuk ndjek logjikë përjashtuese, o njëjërën o tjetrën. Duke mbrojtur idenë se Shqipëria mund të bëhet një shtet më vete edhe pse përbëhet nga disa fe, ai sjell rastin e Kretës, ku thotë: “Feja mund t’i ngjitet mirë një kombësie, pa ia ndryshuar kësaj karakterin etnik. Grekët e konvertuar të Kretës na japin edhe një provë më shumë, megjithëse të myslimanizuar, askush nuk i quan turq.”³

¹ Prof. Dr. Hamit Boriçi, Dr. Mark Marku, *Histori e Shtypit Shqiptar, Nga Fillimet Deri në Ditët Tona*, fq. 207.

² Branko Merxhani, *Vepra*, fq. 237, Shtëpia Botuese Plejad, 2003.

³ Mid’hat Frashëri, *Shqiptarë dhe Sllavë*. Tiranë, shkurt 1998, fq. 52.

Në të njëjtën linjë mendimi është autori bashkëkohor Amin Maalouf, i cili pohon: "Identiteti i dikujt përcaktohet dhe nga shumë elementë të tjerë, si: kombësia, përkatësia fetare, një grup etnik a gjuhësor, profesioni, grupi social, bindjet politike, preferenca të ndryshme etj... Të gjitha përkatësitë kanë rëndësinë e tyre, por jo në të njëjtën kohë. Asnjëra në veçanti nuk e përmbush identitetin e dikujt."⁴

Duke e parë pohimin e Vaso Pashës nën këtë këndvështrim ndaj identitetit, kuptojmë se në periudhën kur ai e shkroi, pjesa e identitetit kombëtar prevalonte mbi ato fetare, por nuk mund të themi se e pengonte formimin e kombit, siç dhe nuk e pengoi realisht, edhe pse shqiptarët "i panë kishat dhe xhamiat".

Këtë qasje mbajtën dhe kultivuan dhe intelektualët e besimeve fetare, idetë e të cilëve do të pasqyrohen në shtypin e kohës.

Shtypi fetar 1925-1944

Do të ndalem në këtë pjesë të shtypit të asaj kohe për vetë rolin e madh dhe tematikat e shumta që janë pasqyruar aty mbi forcimin e elementeve të identitetit kombëtar.

a) Shtypi katolik

Shtypi katolik përfaqësohet me disa organe shtypi me ndikim të madh tek audienca ku ajo mbërrinte. Revistat më me zë ishin *Hylli i Dritës*, *Leka* dhe *Ora e Maleve*.

Revista *Hylli i Dritës*, organi zyrtar i françeskanëve, u ka kushtuar shumë hapësirë çështjeve që ishin në të mirë dhe në të mbarë të kombit, siç dallohet qartë dhe në akt-themelimin e kësaj të përkohshmeje: "... t'u përkujdesshin për t'marë e t'mirë t'kombit shqyptar si nder kohë t'kaluem..."⁵

Duke hulumtuar numrat e kësaj reviste lexojmë një shkrim ku vlerësohet harmonia fetare dhe atdhedashuria që i karakterizonte shqiptarët, por që njëkohësisht përkthehet dhe si nxitje për t'i ruajtur këto dy tipare shqiptare. Gjatë pasqyrit të festimit madhështor të

⁴ Amin Maalouf, *Identitete Vrastare*, Botimet Onufri, botimi i 2-të. Tiranë, 2006, fq. 16.

⁵ Revista *Hylli i Dritës*, Nr. 1, 1 tetor 1913. "Themelimi i Përkohshmjes", fq. 1.

festës së pavarësisë më 1913 në Shkodër, ajo shkruan: “Kumbanarja e kishës së Gjuhadolit që lidhur me minaren e xhamisë së Fushës së Çelës me një tel mbi të cilin valvitej flamuri kombëtar ndërmjet rreshtit të gjatë të kandilave kuq e zi.”⁶ Këtu kemi katër elementë të rëndësishëm, që janë, kisha, xhamia, flamuri kombëtar dhe ngjyrat kuq e zi.

Në artikullin “A jemi shqyptarë a por do të bahemi?” shtjellohen termat shtet, popull e komb. Aty hasim një logjikë shtetformuese, ku sillen shembujt e Anglisë, Gjermanisë apo Spanjës, që edhe pse kanë banorë me fe dhe kultura të ndryshme, përsëri jetojnë bashkarisht nën një shtet.⁷

Një tjetër shkrim që kjo revistë përdor për të shprehur dashurinë ndaj vendit është dhe vjersha nga P. Vinçenc Prenushi, “Nana shqyptare”, ku flitet për luftën e popullit shqiptar për liri.⁸ Po në këtë numër kemi dhe dy shkrime të tjera historike, njëri, “Për historinë e Alfabetit shqip”, dhe tjetri, “Njëzet e pesë vjetori i Kongresit të Manastirit”.⁹

Tjetër organ shtypi katolik është dhe revista *Leka*. Ajo boton një artikull me titull, “Ndjesia instiktive e atdheut”, ku tregon se malli për atdheun e djeg shpirtin e mërgimtarit.¹⁰

Në rubrikën “kulturë” botohet një studim për problemet e gjuhës shqipe, që, siç shkruhet, “Gjuha po na bastardohej”. Këtu u bëhet thirrje intelektualëve të japin kontributin e tyre në mbrojtjen e kësaj pasurie kombëtare.¹¹

Këto janë fakte ku tregohet rëndësia që u ka dhënë kjo revistë disa elementeve që e dallojnë një komb nga një tjetër, siç është vlerësimi i gjuhës shqipe.

b) Shtypi islam

⁶ *Hylli i Dritës*, Nr. 11, 1 nëntor 1937, “Flamuri kombëtar në krahinë të Shkodrës”, fq. 535.

⁷ *Hylli i Dritës*, Nr. 12, 1 dhjetor 1930, fq. 650-656.

⁸ *Hylli i Dritës*, Nr. 11, 1 nëntor 1933, fq. 508.

⁹ *Hylli i Dritës*, Nr. 11, 1 nëntor 1933, fq. 514-524.

¹⁰ *Leka*, Nr. 1, janar 1930, z. Mark Harapi, “Ndjesia instiktive e atdheut”, fq. 3.

¹¹ *Leka*, Nr. 6, nëntor 1930, “Gjuha po na bastardohej”, fq. 161-168.

Shtypi islam përfaqësohet me revistat *Zani i Naltë*, *Kultura Islame* dhe *Njeriu*.

Edhe ky shtyp u ka kushtuar shumë hapësirë shkrimeve ku theksohen elementet e shtetit dhe kombit. Në shkrimin “Valo Flamur!” thuhet: “Përpara këtij bashkimi çduket çdo dasi krahinore e religjioze.”¹² Këtu del qartë se flamuri merret si simbol i bashkimit kombëtar.

Në një tjetër shkrim, lexuesit i sillen në kujtesë vargjet e njohura nga poema “Bagëti e Bujqësi”: “Ti Shqipëri më jep nder, më jep emrin shqipëtar, zemrën ti ma gatove, plot me dëshirë e me zjarr.”¹³

Kultura Islame boton një shkrim ku i bëhet jehonë periudhës kur kufijtë mes Kosovës dhe Shqipërisë ishin zhdukur gjatë pushtimit fashist. Aty thuhet: “... jemi të sigurtë e të bindur se Shqipëria do të gëzojë liri dhe paqe, duke përmbledhur në gjirin e saj edhe tokat ku flitet shqipja e ku banojnë shqiptarë, për t’u bërë një Shqipëri e madhe, e fortë dhe ideale”.¹⁴

Për të treguar dashurinë që duhet të kemi për atdheun, ajo boton një shkrim me karakter historik, ku tregohet momenti kur Profeti Muhamed thotë pasi e detyruan të largohet nga vendlindja, “Ti je vendi më i dashur në sipërfaqen e tokës, dhe më i zgjedhur për mua. Po të mos më kishin përzënë larg teje, unë kurrë nuk do të largohesha nga ti.”¹⁵

Një problem tjetër që hasim në këtë periudhë është dhe përçarja që duan të fusin mes shqiptarëve me besime të ndryshme. Në poezinë “Jeni të gabuar” lexojmë: “Ishin gjithë shqiptarë, nuk dallonin Fe, Feja për ta ishte Liri e Atdhe.”¹⁶

¹² *Zani i Naltë*, Nr. 3, nëntor 1931, fq. 76.

¹³ *Zani i Naltë*, Nr. 11, nëntor 1937, Neshet Çami, “Dy fjalë mbi 25 vjetorin”, fq. 321-328, nëntor 1931.

¹⁴ *Kultura Islame*, Viti II, Nr.15, nëntor 1940, Refik H Bezhani, “Përvjetori i Njëzetetëti i Pamvarsisë 28 Nëntor 1912”, fq.75.

¹⁵ *Kultura Islame*, Viti III, Nr.3-4, nëntor-dhjetor 1941, “Përhapja e Islamizms”, fq. 85.

¹⁶ *Kultura Islame*, Viti III, Nr.3-4, nëntor-dhjetor 1941, Pseudonimi Kom., “Jeni të gabuar!”, fq. 86.

Urrejtja ndërfetare dhe ndërkrahinore që duan të mbjellin nuk ka gjetur vend tek rilindasit tanë, “Çajupi nga Jugu, Fishta nga veriu, pse kjo farë e hidhur ndër Ta nuk mbiu? Si këta dhe shumë, kemi dhe të tjerë, po të kësaj toke, të Shqipërisë së mjerë.”¹⁷

Një tjetër revistë e klerit mysliman të sektit bektashian ishte dhe *Njeriu*. Ajo i ka kushtuar shumë shkrime atdhedashurisë, gjuhës shqipe dhe kulturës kombëtare. Numri i pestë i kësaj reviste, në nëntor të vitit 1942, i kushtohet tërësisht flamurit, në përkujtim të 30-vjetorit të pavarësisë.

c) Shtypi ortodoks

Shtypi ortodoks boton në këtë periudhë fletoren *Gjergj Kastrioti, Skënderbeu, Organ Shpirtnuer për Orthodoxët e Shqipërisë*. Përzgjedhja e emrit fillestar, i cili më pas do të bëhet *Skënderbeu*, është mjaft domethënëse. Botuesi i saj ka qenë teologu Visar Xhuvani, i cili sqaron se emri është vendosur në nder të heroit tonë kombëtar. Kjo fletore u botua deri më 2 mars 1925, në 23 numra.¹⁸

Zgjedhja e ditës dhe e datës së organizimit të ceremonisë për të shpallur Kishën Ortodokse Autoqefale Shqiptare, “KOASH”, është tregues i rëndësishëm për ndjenjën kombëtare që ky komunitet donte të nguliste tek ortodoksët shqiptarë. Ajo u realizua “ditën e ngritjes së flamurit kombëtar më 28 Nëntor 1921 në Kishën e Evangjelizmos në Tiranë ku morën vendimin për shpalljen e KOASH.”¹⁹

Përfundime

Nëse do të bënim një përmbledhje të ideve kryesore të viteve 1925-1944 të pasqyruara në shtypin e kohës, nisur dhe nga idetë që qarkullonin dhe në Europën e asaj kohe, do të shohim se: “Për të rinjtë që përkrahnin modelin e diktaturës së ndritur, Evropës liberale i kishte ardhur fundi; për neoshqiptarët, qytetërimi evropian duhej shartuar me kulturën shqiptare për të mos lejuar tendencat

¹⁷ Po aty.

¹⁸ Fletore *Gjergj Kastrioti*, më pas, *Skënderbeu, Organ Shpirtnuer për Orthodoxët e Shqipërisë*. 19 tetor 1924-2 Mars 1925.

¹⁹ Shyqyri Hysi, *Histori e Komuniteteve Fetare shqiptare*, Tiranë, 2006, fq.174.

individualiste që të dëmtonin njësinë organike kombëtare; për 'demokratët', Evropa e kalbur borgjeze po shkonte me revan drejt një lufte të re botërore, prej së cilës duhet të lindte Evropa e punëtorëve dhe fshatarëve; për klerikët katolikë (dhe të besimeve të tjera; G.L.), tendencat materialiste, individualiste, laiciste dhe ateiste që përmbante qytetërimi modern evropian nuk duheshin lejuar që të depërtonin në Shqipëri."²⁰

Bibliografia:

- 1- Mid'hat Frashëri, *Shqiptarë dhe Sllavë*, Tiranë, shkurt 1998.
- 2- Amin Maalouf, *Identitete Vrastare*, Botimet Onufri, botimi i 2-të. Tiranë, 2006.
- 3- Revista *Hylli i Dritës*, 1913-1944.
- 4- Revista *Zani i Naltë*, 1923-1939.
- 5 Revista *Leka*, 1930-1944.
- 6- Revista *Kultura Islame*, shtator 1939-1945.
- 7- Prof. Dr. Hamit Boriçi, Dr. Mark Marku, *Histori e Shtypit Shqiptar, Nga Fillimet Deri në Ditët Tona*, Sh.B.L.U. Tiranë, 2010.
- 8- Fletore Gjergj Kastrioti, më pas, *Skënderbeu, Organ Shpirtnuer për Orthodoxët e Shqipnisë*, 19 tetor 1924-2 mars 1925.
- 9- Revista *Fetare, Zëri i Orthodoxsisë*, nr. 3, 1 janar 1925, botuar në Korçë.
- 10- Shyqyri Hysi, *Histori e Komuniteteve Fetare shqiptare*, Tiranë, 2006.
- 11- Enis Sulstarova, *Jam Evropë!*, fq. 411-412.
- 12- Revista *Njeriu*, korrik 1942-shtator 1944.

²⁰ Enis Sulstarova, *Jam Evropë!*, fq. 411-412.